



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 8/2022 regjistër (JR)
Datë 15.02.2022

Nr. 21 i vendimit
Datë 17.06.2022

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Ina Rama	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar
Mimoza Tasi	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 17.06.2022, ditën e premte, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Marie Tuma, me Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Selami Zalli, ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë.

OBJEKTI: Ndryshimi pjesërisht i vendimit nr. 494, datë 23.12.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke shfuqizuar pikën 2, që parashikon: *Ndalimin e emërimit të z. Selami Zalli si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, ose:*
Prishjen e vendimit nr. 494, datë 23.12.2021 dhe urdhërimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit të vazhdojë të kryejë procesin e rivlerësimit për subjektin Selami Zalli.

BAZA LIGJORE: Neni 63 i ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim, i cili kërkoi përfundimisht ndryshimin e pjesës së vendimit nr. 494 , datë 23.12.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lidhur me pikën e dytë të dispozitivit që përcakton ndalimin e së drejtës së këtij subjekti për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, ose prishjen e këtij vendimi dhe urdhërimit të Komisionit të vazhdojë të kryejë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Selami Zalli, dëgjoi gjyqtaren relatores Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Selami Zalli ka ushtruar funksionin e ndihmësit ligjor të Gjykatës së Lartë, prej datës 22.07.2009 deri më datë 28.03.2017. Bazuar në nenin 179/b, pika 4 e Kushtetutës dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, ndaj tij ka nisur procesi i rivlerësimit *ex officio* prej Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”).
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente, në përputhje me nenet 31, pika 1; 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional.
3. Në datën 24.03.2017, z. Selami Zalli ka paraqitur para Kryetarit të Gjykatës së Lartë kërkesë për lirim nga detyra e ndihmësit ligjor, pasi ishte shpallur fitues në konkurrimin e zhvilluar për pozicionin e Drejtorit të Informacionit pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Mbi bazën e kësaj kërkesë, Kryetari i Gjykatës së Lartë, me urdhrin nr. {***}, datë 28.03.2017, ka vendosur lirim të z. Selami Zalli nga detyra e ndihmësit ligjor, pranë anëtarit të Gjykatës së Lartë, z. G. Z., me kërkesën e tij. Nga kjo datë e në vijim, z. Selami Zalli ushtron veprimtarinë e tij profesionale pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.
4. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njoftuar nga Komisioni për nisjen e procesit të tij të rivlerësimit me anë të postës elektronike (*e-mail*) në datën 23.09.2021, ka komunikuar me Komisionin duke pretenduar, ndër të tjera, se ai nuk është subjekt i ligjit nr. 84/2016, pasi procedurat për kalimin në detyrën që ushtron tek Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, kanë nisur prej tij para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, duke i bashkëlidhur këtij komunikimi edhe aktet përkatëse që dëshmojnë shprehjen e interesit për pozicionin e anëtarit të Autoritetit që në datën 01.08.2015. Në këtë korrespondencë, subjekti i rivlerësimit i ka vënë në dispozicion Komisionit edhe kërkesën e Shkollës së Magjistraturës, drejtuar Gjykatës së Lartë, me objekt “Mbi organizimin e testimit të aftësive profesionale “*ex officio*”, i cili u kërkon gjykatave të informojnë Shkollën e

Magjistraturës, brenda datës 13 mars 2018, mbi numrin e subjekteve të rivlerësimit që do t'i nënshtrohen këtij procesi”, duke sqaruar se nuk ka marrë pjesë në testimin e kryer nga Shkolla e Magjistraturës, pasi nuk është përfshirë prej saj në listën e personave që duhej të kryenin këtë testim.

5. Në dokumentin e emërtuar “Kërkesa paraprake”, të datës 23.09.2021, subjekti kërkon nga Komisioni pushimin e procesit të rivlerësimit pasi ai nuk ushtron prej kohësh detyrën e ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë, si dhe nga ky funksion është larguar me dorëheqje jo sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës, por për shkak të largimit në një detyrë tjetër (për të cilën kishte aplikuar që në vitin 2015), me një status më të mirë nga ai që kishte më parë. Në vijim, Komisioni ka komunikuar me subjektin e rivlerësimit duke i kërkuar që ai të shprehet për marrjen pjesë ose jo në seancë dëgjimore, përkatësisht me *e-mail*-et e datave 07.10.2021 dhe 08.10.2021, të cilave subjekti u është përgjigjur në datën 21.10.2021 dhe i ka kërkuar Komisionit që të shprehet për kërkesën e tij paraprake. Komisioni i është përgjigjur subjektit me *e-mail*-in e datës 03.11.2021, duke i bërë me dije qëndrimin rreth kërkesës së subjektit, sipas të cilit ka vlerësuar se subjekti ka statusin e subjektit të rivlerësimit që në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 dhe i ka kërkuar atij që të japë shpjegime dhe të sqarojë pozitën juridike të statusit dhe mënyrën e përfundimit të këtij statusi, bazuar në ligjin nr. 84/2016 dhe Aneksin e Kushtetutës.
6. Në datën 05.11.2021, subjekti i rivlerësimit i është drejtuar sërish Komisionit duke i përsëritur kërkesën për të marrë në konsideratë faktin se ai nuk ishte më subjekt rivlerësi. Kjo korrespondencë vijon me *e-mail*-in e datës 23.11.2021, nëpërmjet të cilit Komisioni i ka përcjellë subjektit të rivlerësimit “Rezultatet paraprake të hetimit administrativ”, duke i bërë me dije se ka të drejtë të njihet me aktet e dosjes dhe se ka të drejtë për të kërkuar thirrjen e dëshmitarëve dhe marrjen e provave në funksion të procesit të rivlerësimit. Me anë të këtij komunikimi, Komisioni e rifton subjektin e rivlerësi në seancë dëgjimore publike më datë 01.12.2021. Pas këtij njoftimi, subjekti, po me datë 01.12.2021, ka kërkuar përjashtimin e të gjithë trupës gjyquese të Komisionit, kërkesë e cila, pasi është shqyrtuar nga një trupë tjetër, është konsideruar jo e drejtë dhe, si e tillë, nuk është pranuar.
7. Pasi ka rimarrë kohë shtesë për përgatitjen e mbrojtjes së tij, më datë 21.12.2021, subjekti i rivlerësimit i ka përcjellë Komisionit parashtrimet për seancën dëgjimore të datës 22.12.2021 dhe ka njoftuar Komisionin se, për arsye objektive dhe të angazhimeve në detyrën që ai ushtron, është në pamundësi për të marrë pjesë në këtë seancë. Në parashtrime, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar nga Komisioni:
 - (i) *Pushimin e procesit të rivlerësimit, pasi nuk jam pjesë e ligjit dhe subjekt i tij, bazuar në normat ligjore.*
 - (ii) *Nëse vlerësoni se jam subjekt rivlerësi në kuptim të ligjit nr. 84/2016, kërkoj çeljen e hetimit administrativ, për të cilin do të jem bashkëpunues për një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, për të tria kriteret e vlerësimit të përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji.*

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

8. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 494, datë 23.12.2021, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 57 të ligjit nr. 84/2016

“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 64 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka vendosur:

1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Selami Zalli.
2. Ndalimin e emërimit të z. Selami Zalli, si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.

III. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit

9. Subjekti i rivlerësimit Selami Zalli, më datë 07.02.2022, ushtroi ankim ndaj vendimit të Komisionit nr. 494, datë 23.12.2021, duke pretenduar se ky vendim është marrë në cenim të së drejtës së subjektit për një proces të rregullt ligjor dhe si pasojë e interpretimit të gabuar të statusit të subjektit, sipas Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.
10. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.
 - 10.1. Vendimi i Komisionit ka cenuar parimet e procesit të rregullt ligjor pasi:
 - i. Gjatë hetimit administrativ është cenuar e drejta për hetim efektiv, parimi i barazisë së armëve dhe standardi i arsyetimit të vendimit.
 - ii. Është cenuar parimi i sigurisë juridike dhe i së drejtës për një jetë private në lidhje me veprimtarinë me natyrë profesionale.

10.2. Vendimi i Komisionit është marrë në zbatim të gabuar të ligjit nr. 84/2016 në lidhje me dorëheqjen.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. *Mbi aspektet procedurale të gjykimit*

a) Juridiksioni i Kolegjit

11. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin Selami Zalli, dhe për ndalimin e emërimit të tij, si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, për të cilin subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet ankimit, kërkon ndryshimin e tij, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

b) *Legjitimimi i ankuesit*

12. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

13. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”) për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike. Lidhur me çështjen objekt gjykimi, e cila i përket shqyrtimit të ankimit të subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit të Komisionit nr. 494, datë 23.12.2021, Kolegji vlerësoi se nuk gjendej para asnjë prej rasteve të parashikuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, pasi *së pari*, subjekti, me ankimin e tij, nuk ka paraqitur asnjë kërkesë për marrjen e një ndonjë prove të re, sipas pikës “a” të kësaj dispozite; dhe *së dyti*, nga shqyrtimi i akteve të administruara në fashikullin e krijuar nga Komisioni, rezulton se prej këtij të fundit, subjekti është njoftuar për zhvillimin e seancës dëgjimore për procesin e tij të rivlerësimit dhe më datë 21.12.2021, ai i ka përcjellë Komisionit parashtrimet e tij për seancën dëgjimore, duke njoftuar Komisionin se për arsye objektive dhe të angazhimeve në detyrën që ai ushtron, është në pamundësi për të marrë pjesë në këtë seancë. Nga aktet e administruara në fashikull, rezulton se në seancë dëgjimore, nga komisioneri, kryesues i trupës gjyqësore, janë lexuar parashtrimet e përcjella me shkrim nga subjekti i rivlerësimit, i cili nuk ishte prezent në të. Referuar sa më sipër, duke marrë parasysh faktin që në ankim, subjekti nuk ngre pretendime që lidhen me rregullshmërinë e zhvillimit të seancës dëgjimore, si edhe analizën që u bëhet rrethanave procedurale të rastit, Kolegji konstaton se zhvillimi i procesit të rivlerësimit në Komision për subjektin Selami Zalli, nuk evidenton ndonjë shkeljeje procedurale, në kuptim të nenit 51, germa “a” apo “b” e ligjit nr. 49/2019. Në këto kushte, Kolegji vlerësoi se çështja mund të zgjidhej nëpërmjet gjyqimit në dhomë këshillimi, mbështetur në aktet që gjenden të administruara në fashikullin e Komisionit të përcjellë në Kolegji, konform rregullave të përcaktuara në nenin 49 të ligjit nr. 49/2012 dhe në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit

14. *Në lidhje me pretendimin e ankimit të subjektit të rivlerësimit se vendimi i Komisionit objekt shqyrtimi ka cenuar parimet e procesit të rregullt ligjor, Kolegji analizon sa vijon.*

14.1. Në ankim, subjekti për këtë shkak shprehet se e drejta e individit për një proces të rregullt ligjor, nuk kufizohet vetëm në procesin gjyqësor, por përfshin edhe atë me karakter administrativ, duke pretenduar se çdo organ i pushtetit publik, gjatë ushtrimit të funksioneve të tij kushtetuese e ligjore, është i detyruar të respektojë standardet e gjithëpranuara demokratike që lidhen me procesin

e rregullt, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutë, si njohja paraprake e personit me faktet që e ngarkojnë atë me përgjegjësi, respektimi i së drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur.

14.2. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, në drejtim të zbatimit prej Komisionit të parimeve të procesit të rregullt ligjor, referuar të dhënave të fashikullit të krijuar nga Komisioni përgjatë hetimit administrativ, Kolegji konstaton se:

- Komisioni e ka njoftuar subjektin për trupën gjyquese dhe i ka kërkuar të shprehet nëse është në kushtet e konflikti të interesit.
- Komisioni ka pasur një komunikim të vazhdueshëm me subjektin, të cilin e ka njoftuar për qëndrimin e tij se ai gjendet në kushtet e ndërprerjes së procesit dhe marrjes së përgjegjesisë që prodhon neni G i Aneksit të Kushtetutës, e ka ftuar të njihet me aktet e dosjes, i ka përcjellë rezultatet e hetimit, duke i bërë me dije se ka të drejtën të kërkojë marrjen e provave apo pyetjen e dëshmitareve.
- Komisioni, disa herë e ka ftuar subjektin në seancë dëgjimore publike dhe është ky i fundit, që nuk ka pranuar të marrë pjesë, por ka kërkuar të administrohen parashtrimet e tij me shkrim.

14.3. Nisur nga kjo situatë faktike që rezultojnë nga të dhënat e administruara në fashikullin e hetimit administrativ të Komisionit, konstatohet se procedurat e zhvilluara nga ky organ, në funksion të procesit të rivlerësimit të subjektit Selami Zalli, janë kryer në përputhje me parimet e procesit të rregullt ligjor, në drejtim të së drejtës për informim, si dhe përcaktimeve të nenit 46 të ligjit nr. 84/2016, për sa kohë që nga aktet e administruara, rezultojnë se Komisioni ka njoftuar subjektin e rivlerësimit për secilën fazë në të cilën ndodhej hetimi dhe për vendimmarrjet e tij lidhur me të. Nga analiza e përmbajtjes së komunikimit mes Komisionit dhe subjektit në periudhën kohore gjatë së cilës është zhvilluar procedura administrative në Komision, rezultojnë se, me qëllim për t'i garantuar subjektit ushtrimin e plotë të së drejtës për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur, Komisioni ka shqyrtuar në kohë kërkesat paraprake të subjektit në drejtim të procesit të rivlerësimit dhe të trupës gjyquese, ka shtyrë afatin për paraqitjen e parashtrimeve nga subjekti dhe e ka thirrur të dëgjohet në seancën dëgjimore të caktuar për procesin e tij të rivlerësimit, tek e cila rezultojnë se subjekti, edhe pse kishte marrë dijeni, nuk është paraqitur, duke përcjellë qëndrimin e tij me shkrim. Kolegji nuk konstaton sjellje apo shfaqje të anësisë apo mungesës së pavarësisë së trupës gjyquese përgjatë procesit të rivlerësimit dhe as mangësi në strukturën arsyetuese të vendimit të Komisionit, në kuptim të përcaktimeve të nenit 57 të ligjit nr. 84/2016.

14.4. *Subjekti në ankim pretendon se në vendim nuk ka gjetur analizim /arsyetim qëndrimi i tij gjatë hetimit administrativ, përgjatë të cilit ai ka shprehur qartë vullnetin që, nëse vlerësohet se duhet të vijojë procesi, ai ka kërkuar kryerjen e një hetimi administrativ të plotë sipas ligjit nr. 84/2016 për të tria kriteret, pasurinë, figurën dhe aftësitë profesionale.* Lidhur me këtë pretendim të subjektit, Kolegji analizon se:

14.5. Komisioni ka kryer dhe ka përfunduar me ndërprerje procesin e rivlerësimit që i përkiste subjektit të rivlerësimit sipas parashikimit kushtetues dhe ligjor. Për shkak të specifikave të rastit, Komisioni nuk e ka parë të arsyeshme e të nevojshme të zhvillojë një hetim administrativ drejt vlerësimit të kriterëve të rivlerësimit, pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale, por është ndalur në analizimin e kushteve dhe rrethanave specifike të rastit që e kanë çuar drejt vendimit se procesi duhej

ndërprerë. Në këto kushte, Komisioni nuk e ka konsideruar të drejtë e të arsyeshëm hetimin në drejtimet e mësipërme të pretenduara prej subjektit.

14.6. Në këtë kuptim, pretendimi i subjektit se Komisioni nuk ka analizuar e arsyetuar lidhur me këtë kërkim të tij, shihet i lidhur me faktin që qëndrimi i Komisionit ka qenë i orientuar drejt një vendimmarrjeje me natyrë procedurale dhe pa i hyrë thelbit të procesit, qëndrim i cili i është bërë me dije edhe subjektit përgjatë procedurës administrative. Fakti që subjekti e ka kontestuar këtë qëndrim dhe nuk është dakord me të, nuk afekton procedurën e zhvilluar prej Komisionit në drejtim të procesit të rregullt ligjor. Ky pretendim i subjektit u analizua prej Kolegjit në analizën e shkaqeve të ankimit që lidhen me zbatimin e drejtë të ligjit lidhur me trajtimin e statusit të subjektit dhe efektin që ai ka në procesin e rivlerësimit të tij, pa konstatuar ndonjë shkelje të natyrës procedurale, që do e cenonte vendimin në drejtim të procesit të rregullt ligjor.

14.7. *Lidhur me pretendimin e subjektit se i është cenuar parimi i sigurisë juridike dhe i së drejtës për një jetë private në lidhje me veprimtarinë me natyrë profesionale, Kolegji analizon sa vijon.*

14.8. Së pari, lidhur me zbatimin e parimit të sigurisë juridike, Kolegji vlerëson se interpretimi i rastit të subjektit të rivlerësimit nën rregullimin ligjor të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, nuk cenon parimin e sigurisë juridike të mbrojtur nga Kushtetuta e Shqipërisë. Përmbajtja e nenit G të Aneksit të Kushtetutës është elaboruar në vendimin nr. 78/2017 të Gjykatës Kushtetuese, nëpërmjet një interpretimi që kjo gjykatë u bëri shtrirjes në kohë dhe efekteve ligjore të dorëheqjes në raport me kohën e ushtrimit të saj prej subjekteve të rivlerësimit. Interpretime të mëpasshme të kësaj dispozite ka bërë Kolegji i Posaçëm i Apelit, si e vetmja gjykatë e këtij procesi, në vendimet e tij¹, nën të drejtën për të unifikuar dhe interpretuar edhe në rrafshin kushtetues institute të posaçme të procesit të rivlerësimit. Komisioni, në rastin konkret, nuk duket sa ka tejkalar apo ndërmarrë hapa proceduralë, apo interpretuar këtë dispozitë në një mënyrë të ndryshme nga sa e ka interpretuar Kolegji në jurisprudencën e tij të njohur tashmë. Në këtë kontekst, pretendimi i subjektit se Komisioni ka cenuar këtë parim, në kushtet kur zbatimi i kësaj dispozite prej Komisionit është kryer në përputhje me rastet e tjera të ngjashme dhe me jurisprudencën e Kolegjit, vlerësohet si një pretendim i pambështetur.

14.9. Së dyti, referimi te rasti i trajtuar në vendimin nr. 115, datë 11.03.2019, të Komisionit që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. M. Xh., gjendet prej Kolegjit si jorelevant, për sa kohë që mes rastit të përmendur dhe çështjes objekt shqyrtimi qëndron në themel një ndryshim i rëndësishëm lidhur me situatën faktike. Ndërsa në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. M. Xh., Komisioni kishte konsideruar se ajo nuk e gëzonte statusin e subjektit të rivlerësimit në zbatim të nenit 179/b të Kushtetutës dhe, për pasojë, ndaj saj nuk mund të kryhej procesi i rivlerësimit, në rastin e subjektit Selami Zalli, Komisioni ka konkluduar se ai e gëzonte këtë status në kohën e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese dhe të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit, me vullnetin e tij, e ka humbur statusin për shkak të dorëheqjes nga detyra që mbante dhe, për pasojë, procedura që do të zhvillohej ndaj tij *ex officio*, duhej të ndërpritej duke u shoqëruar me aplikimin e pasojave të nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Kolegji vëren se midis këtyre dy rasteve nuk ka analogji, referuar situatës faktike, për pasojë nuk mund të pretendohet për analogji në legjislacionin e zbatueshëm dhe mënyrën

¹ *Shih vendimet e Kolegjit (JR) nr.18/2020; (JR) nr. 19/2020; (JR) nr. 17/2021.*

e zgjidhjes së çështjes, konkluzion i cili, krahas atij të arsytuar më lart, e bën pretendimin e subjektit për cenim të parimit të sigurisë juridike, të pambështetur në prova e në ligj.

Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se vendimi i Komisionit cenon të drejtën e tij për një jetë private sepse cenon veprimtarinë me natyrë profesionale, Kolegji konstaton, në analizë të fakteve të prezantuara prej vetë subjektit, se kjo rrethanë nuk provohet se ekziston. Subjekti aktualisht ushtron detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Informacionit pranë institucionit shtetëror të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Ai e ka siguruar këtë funksion sipas një aplikimi të kryer prej tij, duke konkurruar për këtë pozicion sipas rregullave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi që në vitin 2017. Në këto kushte, rezulton se vendimi i Komisionit objekt shqyrtimi nuk i ka mohuar subjektit të drejtën e ushtrimit të profesionit, të cilin ai e ushtron në mënyrën dhe pozicionin që ai me vullnet ka zgjedhur, por ka kufizuar vetëm ushtrimin e funksioneve në sistemin gjyqësor, sipas kufizimit të përcaktuar në normën kushtetuese. Për rrjedhojë, Kolegji, këtë pretendim të subjektit, e gjen të paargumentuar e të pabazuar në prova dhe në ligj.

14.10. Në përmbledhje, Kolegji i gjen shkaqet e ankimit që lidhen me procesin e rregullt ligjor, si të pambështetura në fakte dhe në ligj.

- 15.** *Në lidhje me shkakun e ankimit se, referuar situatës faktike, vendimi i dhënë nga Komisioni është marrë në zbatim të gabuar të ligjit, pasi në rastin e tij, Komisioni duhej të merrte një vendim jopërfundimtar, duke e ndërprerë/pushuar procesin e tij të rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit 95 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, i ndryshuar ose të vijonte me procesin e rivlerësimit, Kolegji analizon sa vijon.*

15.1. Në mbështetje të këtij shkak, në ankim, subjekti pretendon se prej Komisionit nuk është vlerësuar fakti që dorëheqja e tij nuk është bërë duke iu referuar nenit G të Aneksit të Kushtetutës dhe, për këtë shkak, ajo nuk i është drejtuar as Presidentit të Republikës, dhe se subjekti nuk ka përfituar as pagesë kalimtare. Subjekti pretendon se dorëheqja e tij duhet gjykuar thjesht si një shprehje vullneti për të shkuar në një detyrë tjetër dhe jo si mekanizëm për t’iu shmangur rivlerësimit kalimtar, për të cilin ai thekson se ka kërkuar nga Komisioni rivlerësim të të tria kriterëve.

15.2. Për t’i dhënë përgjigje këtij shkak ankimi, i cili përfaqëson edhe thelbin e ankimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi të analizojë së pari, situatën faktike që i përket ndërprerjes së marrëdhënies së punës së subjektit, si ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë; së dyti, të analizojë vullnetin e tij për t’u larguar nga ajo marrëdhënie në kuptim të nenit G të Aneksit të Kushtetutës dhe, në konkluzion, të analizojë kërkimin alternativ të subjektit për vijimin e procesit të tij të rivlerësimit.

15.3. Sipas të dhënave që burojnë nga aktet e administruara në Komision, rezulton se:

- Në datën 24.07.2015, është bërë njoftimi për shpalljen e vendeve vakante për anëtar të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, nga Kuvendi i Shqipërisë.
- Subjekti i rivlerësimit i është drejtuar Presidentit të Republikës, me kërkesën e datës **01.08.2015**, “Për shprehje interesi për vendin vakant pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”.
- Sipas procesverbalit të datës **16.10.2015** të Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut të Kuvendit të Shqipërisë, rezulton se z. Selami Zalli ka zhvilluar seancën dëgjimore para këtij Komisioni në funksion të kandidimit të tij për të qenë anëtar pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

- Me kërkesën e subjektit të rivlerësimit, datë 24.03.2017, të paraqitur para Kryetarit të Gjykatës së Lartë, ai ka kërkuar lirimin nga detyra e ndihmësit ligjor, pasi ishte shpallur fitues në konkurrimin e zhvilluar për pozicionin e Drejtorit të Informacionit pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.
- Me urdhrin nr. {***}, datë 28.03.2017, të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, është vendosur lirimi i z. Selami Zalli nga detyra e ndihmësit ligjor, pranë anëtarit të Gjykatës së Lartë, z. G. Z., me kërkesën e tij.
- Sipas shkresës nr. {***} prot., datë 13.03. 2017, të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, z. Selami Zalli emërohet në nivelin e mesëm drejtues, në pozicionin e Drejtorit në Drejtorinë e Informacionit pranë këtij Autoriteti.

15.4. Nga burimet e hapura të aksesueshme lehtësisht prej Kolegjit dhe të panevojshme të provohen me prova sepse kanë statusin e fakteve të njohura botërisht, sipas përcaktimit të nenit 13 të Kodit të Procedurës Civile, rezulton se në muajin nëntor 2016, Kuvendi i Shqipërisë votoi² anëtarët e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në të cilët subjekti nuk bënte pjesë, duke përmbyllur në këtë mënyrë procedurën për të cilën subjekti kishte aplikuar në vitin 2015.

15.5. Nga analizimi i fakteve të renditura si më sipër, rezulton se pretendimi i subjektit se ai ka shfaqur vullnetin për t'u larguar nga pozicioni i ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë që në vitin 2015, si një rrethanë që tregon se ai nuk ka dashur t'i shmanget procesit të rivlerësimit, humbet relevancën për trajtimin e shkaqeve të ankimit të tij, për sa kohë që kjo procedurë e nisur prej subjektit ishte përmbyllur që në nëntor të vitit 2016, kohë përpara se subjekti të plotësonte e dorëzonte deklaratat në zbatim të ligjit nr. 84/2016, të cilat janë dorëzuar prej tij në janar 2017. Vullneti i tij i pafinalizuar me emërimin në ndonjë detyrë tjetër para hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese dhe ligjit nr. 84/2016, por edhe para se ai të plotësonte deklaratën *vetting*, nuk e zhveshin subjektin nga pasja e statusit të *subjektit të rivlerësimit* sipas këtij legjislacioni.

15.6. Pavarësisht vullnetit të subjektit për të qenë anëtar i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, të shprehur nëpërmjet kandidimit për këtë pozicion në vitin 2015, ndërprerja e marrëdhënieve të tij të punës në datën 28.03.2017, nuk është bërë për shkak të këtij kandidimi sepse, siç u evidentua, ky proces është përmbyllur prej Kuvendit të Shqipërisë në nëntor 2016, kohë më parë se subjekti të dorëzonte deklaratat sipas ligjit nr. 84/2016. Nga aktet e administruara në Komision, por edhe nga shpjegimet e subjektit, nuk evidentohet koha se kur subjekti ka aplikuar për pozicionin e punës që ai mban në administratën e këtij institucioni, por evidentohet vetëm koha e ndërprerjes së marrëdhënies së punës me Gjykatën e Lartë dhe fillimi i kësaj marrëdhënieje me Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet të ish-Sigurimit të Shtetit, në datën 30.03.2017.

15.7. Në drejtim të analizimit të situatës faktike, në vlerësimin e Kolegjit, merr rëndësi fakti që subjekti në kohën e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese dhe ligjit nr. 84/2016, ushtronte funksionet e ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë, duke plotësuar në këtë mënyrë përcaktimin e pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*. Vetë subjekti e ka konsideruar dhe trajtuar veten në të njëjtën mënyrë, për sa kohë që në janar të vitit 2017, ka plotësuar deklaratat sipas shtojcave të ligjit nr. 84/2016, veprim i cili është përcaktuar të kryhet prej subjekteve të rivlerësimit.

15.8. Në këto kushte, Kolegji çmon se, pavarësisht vullnetit të brendshëm për t'u larguar nga pozicioni i ndihmësit ligjor para se të fillonte procesi i rivlerësimit, në kuptimin formal dhe ligjor kjo shprehje vullneti ka krijuar pasoja ligjore vetëm me kërkesën e drejtuar kryetarit të Gjykatës së Lartë

² Shih: <https://top-channel.tv/2016/11/17/kuvendi-voton-anetaret-e-autoritetit-per-hapjen-e-dosjeve/>.

në datën 24.03.2017, për ndërprerjen e kësaj marrëdhënieje pune. Ndërprerja e marrëdhënieve të punës ka ndodhur për shkak të kërkesës së subjektit të rivlerësimit, e cila, në kuptim të procesit të rivlerësimit, do të konsiderohet dhe kualifikohet ligjërisht si dorëheqje nga detyra, për shkak se është mbështetur në vullnetin e shprehur të vetë subjektit të rivlerësimit. Motivet që e kanë shtyrë subjektin drejt këtij manifestimi vullneti, konsiderohen pa ndikim në kualifikimin e tij si dorëheqje dhe të pasojave ligjore që ai krijon, për sa kohë që vetë kuadri ligjor nuk i ka paraparë ato si përcaktuese për ndonjë konsekuencë të tillë.

15.9. Në përfundim të këtij arsyetimi, Kolegji vlerëson se Komisioni ka aplikuar me të drejtë dispozitat e posaçme që rregullojnë dhe trajtojnë dorëheqjen sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 56 të ligjit nr. 84/2016 dhe jo dispozitat e përgjithshme të Kodit të Procedurave Administrative, të cilat mund të thirren për zbatim vetëm në mungesë të rregullimit të posaçëm sipas përcaktimit të nenit 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016. Subjekti rezultoi të ketë ndërprerë me vullnet marrëdhënien e punës që i jepte atij statusin e subjektit të rivlerësimit, fituar me hyrjen në fuqi të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, duke u gjendur në këtë mënyrë në kushtet e dorëheqjes sipas parashikimit të dispozitave të cituara më lart.

15.10. Në vijim, Kolegji shqyrtoi kërkimin e parë alternativ të subjektit, me anë të të cilit ai kërkon ndryshimin e pikës 2 të vendimit të Komisionit, lidhur me ndalimin e vendosur sipas nenit G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, dhe vlerësoi se ky kërkim gjendet i pambështetur në ligj, duke qenë se disponimi në këtë mënyrë i Komisionit, vjen për shkak të aplikimit të drejtpërdrejtë të dispozitës kushtetuese, e cila shoqëron dorëheqjen nga detyra të subjekteve, me pasojën ligjore të vendosur në vendim. Neni G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës ka parashikuar periudhën 15-vjeçare të ndalimit për të qenë pjesë e sistemit të drejtësisë, si një periudhë fikse në rastet e ndërprerjes së procesit të rivlerësimit, për shkak të dorëheqjes, duke mos u lënë diskrecion organeve të rivlerësimit të vlerësojnë këtë periudhë në varësi të rrethanave të çështjes.

15.11. Në drejtim të kërimit alternativ të subjektit, sipas të cilit vendimi i Komisionit duhet të priset dhe të urdhërohet Komisioni të kryejë procesin e rivlerësimit për të, Kolegji çmon se ai nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore që rregullojnë procesin e rivlerësimit kalimtar dhe as mbështetet në fakte të provuara prej subjektit të rivlerësimit.

Së pari, Kolegji vlerëson të sjellë në vëmendje qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e tij³, sipas së cilës, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, vullneti i subjekteve për të mos iu shmangur procesit të rivlerësimit, shprehet vetëm nëpërmjet qëndrimit në detyrë dhe përfundimit të procesit të rivlerësimit. Në momentin që subjekti i rivlerësimit, me vullnetin e tij të lirë, ndërpret detyrën funksionale, që e bën atë subjekt të procesit të rivlerësimit, *ex-officio*, duhet të marrë parasysh edhe pasojën ligjore që sjell dorëheqja nga detyra në ecurinë e procesit të rivlerësimit, sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

Së dyti, Kolegji vlerëson se humbja e statusit të subjektit të rivlerësimit me vullnetin e tij, pavarësisht motiveve dhe qëllimeve që e shtyjnë atë drejt këtij akti, e bën të pamundur vijimin e këtij procesi të rivlerësimit edhe në kushtet kur subjekti kërkon t'i nënshtrohet atij, duke qenë se ndërprerja e procesit dhe vendosja e ndalimit të parashikuar nga neni G i Aneksit të Kushtetutës, konsiderohet si alternativë imperative dhe e vetme për zbatim në rastet e humbjes së statusit për shkak të dorëheqjes.

15.12. Pavarësisht faktit se Komisioni nuk i ka dhënë një përgjigje shteruese dhe arsyetuese këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, duke qenë se vendimi objekt shqyrtimi i jep zgjidhje indirekte

³ *Shih vendimin e Kolegjit (JR) 17/2019, datë 25.07.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. V. B. (P.).*

edhe këtij kërkimi, duke e konsideruar atë si të pambështetur, si edhe, në rrethanat kur zgjidhja e çështjes konsiderohet e drejtë prej Kolegjit, mungesa në arsyetim e kësaj analize, nuk mund të shërbejë si një shkak për të cenuar vendimin e Komisionit.

16. Në përfundim, mbështetur në konkluzionet e mësipërme, Kolegji e gjen të mbështetur në fakte e në ligj vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi dhe, për pasojë, çmon se ai duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 494, datë 23.12.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit Selami Zalli,
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 17.06.2022.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi - kundër

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e kryesueses së trupit gjykues për shqyrtimin e çështjes (JR) nr. 8/2022, datë 15.02.2022, kam votuar kundër shumicës, për lënien në fuqi të vendimit nr. 494, datë 23.12.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), për subjektin e rivlerësimit Selami Zalli.
2. Çmoj se arsyetimi i përdorur nga Komisioni në vendimin objekt shqyrtimi, i dakordësuar nga shumica e trupit gjykues në Kolegj, është i gabuar pasi:

2.1 Subjekti i rivlerësimit Selami Zalli, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka qenë me detyrë *ndihmës ligjor pranë Gjykatës së Lartë* dhe, në bazë të nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2.2 Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit është njoftuar nga Komisioni më datë 29.07.2021, për fillimin e hetimit administrativ në kuadër të procesit të rivlerësimit, duke iu dërguar pyetëtori standard sipas procedurës. Në datën 23.09.2021, subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet postës elektronike (*e-mail*), ka kërkuar pushimin e procesit të rivlerësimit, pasi statusi i tij, për të cilin i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, nuk ekziston më për arsye objektive që nuk lidhen me procesin. Referuar vendimit të Komisionit, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit në përfundim të parashtrimeve mbi rezultatet e hetimit, ka kërkuar pushimin e procesit të rivlerësimit, pasi nuk ishte subjekt i ligjit, por, nëse nga Komisioni do të vlerësohej e kundërta, ka kërkuar çeljen e hetimit administrativ për të tria kriteret e rivlerësimit.

2.3 Në ankim, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar vendimin e Komisionit i cili ka ndërprerë procesin e rivlerësimit duke aplikuar nenin G të Aneksit të Kushtetutës dhe ndalimin e tij për të ushtruar detyrën e gjyqtarit ose të prokurorit të çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare. Nëpërmjet ankimit, subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji:

i. ndryshimin e vendimit duke kërkuar prishjen e pikës 2 të dispozitivit të vendimit, ose ii. prishjen e vendimit të Komisionit dhe urdhërimin e tij të vazhdojë procedurën e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Selami Zalli.

3. Unë gjyqtare në pakicë, ndodhur në këtë situatë faktike, ligjore dhe procedurale, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit, ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni dhe dakordësuar shumica e trupit gjykues në Kolegj, ka kërkuar në të dyja shkallët e gjykimit, rivlerësimin e tij sipas ligjit, gjë e cila e përjashton automatikisht aplikimin e nenit G të Aneksit të Kushtetutës në këtë rast, pasi nuk ndodhemi përpara kërkesave të kësaj dispozite dhe nenit 56 të ligjit nr. 84/2016.
4. Çmoj se rasti në fjalë nuk është i ngjashëm me rastet e tjera të trajtuara në Kolegj, siç kanë qenë dorëheqja nga detyra e magjistratit, me qëllim shmangien nga procesi i rivlerësimit, rastet e përfitimit të pensionit të parakohshëm, rastet e përfundimit të mandatit të magjistratit në një kohë që ligji parashikonte kalimin e tyre në një detyrë tjetër brenda sistemit të drejtësisë etj. Në këtë rast, subjekti i rivlerësimit Selami Zalli kërkon rivlerësimin e tij si në Komision, ashtu dhe në Kolegj. Z. Selami Zalli ka qenë në detyrën e ndihmësit ligjor me hyrjen në fuqi të paketës ligjore për reformën e drejtësisë dhe, për efekt të ligjit, ka marrë statusin e subjektit të rivlerësimit.
5. Në këtë proces, vlerësoj se duhen mbajtur parasysh disa fakte që pengojnë zbatimin e nenit G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës: *së pari*, sipas dokumentacionit të administruar, subjekti i rivlerësimit ka

shprehur vullnetin e tij që nga viti 2015, për t'u larguar në një detyrë tjetër, përpara se ligji nr. 84/2016 të hynte në fuqi, dhe *së dyti*, ka treguar disponibilitet për t'iu nënshtruar këtij procesi, për të tria kriteret e rivlerësimit.

6. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka parashikuar qartë se, përveç subjekteve të rivlerësimit që janë duke ushtruar detyrën, procesit të rivlerësimit mund t'i nënshtrohen me kërkesë e nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit, edhe ish-gjyqtarët, ish-prokurorët, ish-këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet. Në këtë rast, ligjvënësi nuk ka pasur si qëllim të privojë subjektet e rivlerësimit nga ky proces, pasi ata duhet të jenë të lirë të kryejnë detyra të ndryshme edhe për periudhën e rivlerësimit. Në këto kushte, gjykoj se procedura e rivlerësimit nga Komisioni duhet të kishte vazhduar, duke e vlerësuar si rrugën më të drejtë dhe ligjore të përmbushjes së qëllimit të procesit të rivlerësimit, që në momentin që subjekti i rivlerësimit kërkoi vazhdimin e këtij procesi. Neni G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, në vlerësimin tim, është i zbatueshëm vetëm në ato raste kur subjekti i rivlerësimit bën përpjekje për t'iu shmangur këtij procesi me anë të dorëheqjes.
7. Për sa arsyetuar më sipër, çmoj se vendimi i Komisionit i lënë në fuqi nga shumica e trupit gjykues, duhet të priset, pasi nuk gjen mbështetje në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, ndodhur në kushtet kur në asnjë moment nuk provohet që subjekti i rivlerësimit kërkon dorëheqjen nga detyra sipas kësaj dispozite, me qëllim shmangien nga rivlerësimi, përderisa në të dyja shkallët e gjyqimit, ai kërkon të vazhdojë procedura e rivlerësimit. Duke e vlerësuar vendimin nr. 494, datë 23.12.2021, të Komisionit të pabazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016, çmoj që Kolegji, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa "c" e këtij ligji, duhet të vendoste prishjen e vendimit të Komisionit, për t'i hapur rrugë kështu procesit të rivlerësimit për z. Selami Zalli.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi